

Statistikat e Kulturës

Tremujori II 2017

Tiranë, më 23 Gusht 2017: Në tremujorin e dytë 2017, janë realizuar 217 shfaqje kulturore, duke shënuar rënie me 21,1 %, kundrejt tremujorit të dytë 2016. Numri i spektatorëve në tremujorin e dytë 2017 është rreth 54 mijë, duke pësuar rritje me 34,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab.1 Numri gjithsej i shfaqjeve/ekspozitave në institucionet kulturore

Numri i shfaqjeve/ekspozitave	Tr.1-2016	Tr.1-2017	Tr.2-2016	Tr.2-2017
Teatri Kombëtar Popullor	38	36	29	43
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	40	12	41	21
Teatri Kombëtar Eksperimental	103	102	95	76
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	43	8	39	15
Galeria Kombëtare e Arteve	4	2	7	5
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	58	53	64	57
Shfaqje kulturore gjithsej	286	213	275	217

Pjesëmarrja mesatare në tremujorin e dytë 2017 është 249 spektatorë/vizitorë për shfaqje, dhe ka pësuar rritje me 69,9 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2016.

Tab.2 Numri gjithsej i spektatorëve/vizitorëve në institucionet kulturore

Numri i spektatorëve/vizitorëve/audienca	Tr.1-2016	Tr.1-2017	Tr.2-2016	Tr.2-2017
Teatri Kombëtar Popullor	13.902	12.310	6.522	12.575
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambllit Popullor	10.470	7.779	6.320	16.693
Teatri Kombëtar Eksperimental	12.427	13.647	12.738	10.974
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	2.800	360	1.980	660
Galeria Kombëtare e Arteve	5.020	1.141	5.520	5.841
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	5.726	7.918	7.312	7.396
Numri i spektatorëve gjithsej	50.345	43.155	40.392	54.139

Numri i vizitorëve në muze në tremujorin e dytë 2017 është 56.375, duke shënuar rritje me 36,3 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2016. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 24,3 %, midis tremujorit të dytë 2017 dhe të njëjtit tremujor në vitin 2016. Në tremujorin e dytë 2017 numri i

vizitorëve në parqe arkeologjike është 71.773, me një rritje prej 9,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

Tab. 3 Vizitorë në Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala

Numri i vizitorëve	Tr.1-2016	Tr.1-2017	Tr.2-2016	Tr.2-2017
Muze	15.797	13.327	41.369	56.375
Kala e Monumente të tjera	8.144	12.962	46.720	58.059
Parqe Arkeologjike	5.896	8.606	65.412	71.773
Numri i vizitorëve gjithsej	29.837	34.895	153.501	186.207

Numri i shërbimeve të njërive bibliotekare dhe numri i frekuentuesve të Bibilotekës Kombëtare në tremujorin e dytë 2017 është përgjysmuar krahasuar me tremujorin e dytë 2016. Në tremujorin e dytë 2017, në Bibliotekën Kombëtare janë afishuar 3.322 botime, 1,0 % më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Nga këto botime 661 ishin tituj të rinj dhe 2.661 ekzemplarë të rinj.

Tab. 4 Frekuentimi dhe botimet në Bibilotekën Kombëtare

Treguesit	Tr.1-2016	Tr.1-2017	Tr.2-2016	Tr.2-2017
Shërbimi i njërive bibliotekare (njësi)	41.493	38.343	45.360	22.524
Frekuentimi	51.972	35.707	50.023	26.294
Numri i botimeve	4.369	4.874	3.289	3.322
Numri i titujve të rinj gjatë vitit	869	927	711	661
Numri i ekzemplarëve të rinj gjatë vitit	3.500	3.947	2.578	2.661

Shënime Metodologjike

Në institucionet qendrore të artit përfshihen: Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor (TKOBAP), Teatri Kombëtar (TK), Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" (TKEKS), Galeria Kombëtare e Arteve (GKA), Cirku Kombëtar (CK), Arkivi Qendror Shqiptar i Filmit (AQSHF), Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK), Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave (QKKFTK), Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), Muze, Parqe Arkeologjike dhe Kala.

Të dhënat e statistikave të kulturës sigurohen nga Ministria e Kulturës.